



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Oda e infermierëve, mameve dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës  
Komora medicinskej sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova  
The Kosovo Chamber of nurses, midwives and other health professionals



**KODI ETIK DHE DEONTOLOGJISË I ANËTARËVE TË  
ODËS SË INFERMIERËVE, MAMIVE DHE PROFESIONISTËVE  
TJERË SHËNDETËSORË TË KOSOVËS**

Prishtinë, 2025

**KUVENDI I ODËS SË INFERMIERËVE TE KOSOVËS**, në mbështetje të Nenit 9, paragrafit 1 me nën-paragrin 1.1 dhe Nenin 19, paragrin 1 me nën-paragrin 1.2 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë; Nenin 14, paragrin 1 me nën-paragrin 1.1 dhe Nenin 19, paragrin 1 me nën-paragrin 1.2 të Statutit të Odës, në mbledhjen e rregullt të datës 27.02.2025, miraton:

## **KODIN E ETIKËS DHE DEONTOLOGJISË I ANËTARËVE TË OIK**

### **I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Qëllimi**

**Neni 1**

Kodi i Etikës dhe Deontologjisë i Infermierëve dhe profesionistëve tjerë shëndetësor në tekstin e mëtejmë: Kodi përcakton parimet, rregullat, standardin e sjelljes profesionale dhe etikën, të cilat anëtarët e Odës së Infermierëve të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Oda) janë të detyruar t'i përbahen. Dispozitat e këtij kodi kanë për qëllim të ruajë lirinë dhe reputacionin e profesionit shëndetësor të anëtarëve të Odës, të ngritë cilësinë e shërbimeve shëndetësore dhe të forcojë besimin midis infermiereve dhe pacientëve, besimin ndërkolegial të infermierëve, besimin e infermierëve me profesionistët shëndetësor dhe me publikun, duke respektuar, betimin e hipokratit dhe infermierit, të drejtat themelore të njeriut, konceptin e autonomisë profesionale dhe të drejtave të pacientit të parapara sipas legjislacionit në fuqi.

**Fushëveprimi**

**Neni 2**

Dispozitat e kodit etik janë të detyrueshme për të gjithë anëtarët e Odës, pa marrë parasysh pozitën e tyre në institucionet publike apo private. Veprimi në kundërshtim me dispozitat e këtij kodi, është e sankzionuar komfor Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor

**Termet**

**Neni 3**

Termat e përdorur në Kod, e që kanë një kuptim gjinor, pavarësisht nëse përdoren në gjininë mashkullore apo femërore, përfshijnë gjininë mashkullore dhe femërore në mënyrë të barabartë.

**Odë – Oda e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë shëndetësorë të Kosovës**

**Anëtarë – nënkupton të gjitha profilet të cilat janë të obliguara të anëtarësohen në kuadër të Odës.**

**Privatësia dhe konfidencialiteti** - përfshin të gjitha informacionet që ka Anëtarë gjatë kryerjes së profesionit, për pacientin, rrëthanat personale, familjare dhe shoqërore, si dhe informacionin lidhur me zbulimin, trajtimin dhe shërimin e sëmundjes

**Njohja e legjislacionit**

**Neni 4**

- Çdo anëtar duhet të njohë dhe respekton legjislacionin në fushën e shëndetësisë nga fushëveprimi i profilit, Statutin, Kodin Etik dhe aktet tjera normative të Odës.

2. Aplikimi për anëtarësim në Odë, nënkupton deklarimin e tij për njohurinë mbi përbajtjen e obligimeve etike të anëtarit të Odës.
3. Deklarata nën betim për njohjen e Kodit Etik si dhe të kaluarën etike, bashkëngjitet në shtojcën e këtij Kodi dhe validohet në sistemin elektronik.

## **II. PARIMET THEMELORE**

### **Parimi i ndërgjegjshmërisë**

**Neni 5**

Anëtari është i detyruar të kryejë veprimtarinë e tij profesionale me ndërgjegje, sipas rregullave të profesionit shëndetësor dhe me kujdesin e nevojshëm, në përputhje me parimet e kodit etik si dhe me standarde vendore dhe ndërkontaktuale të të drejtave të njeriut.

### **Parimi i barazisë**

**Neni 6**

Anëtari ofron kujdesin shëndetësor në mënyrë të barabartë për të gjithë pavarësisht nga mosha, gjinia, raca, kombësia, religjioni ose opinioni politik dhe statusi shoqëror, gjuha, kultura, lloji i sëmundjes, paaftësia mendore ose fizike ose tipare të tjera personale, duke respektuar të drejtat dhe dinjitetin e njeriut.

### **Parimi i respektimit të autonomisë dhe të drejtave të pacientëve**

**Neni 7**

Anëtari është i detyruar të respektojë të drejtat, liritë, autonominë dhe dinjitetin njerëzor të secilit pacient, si dhe të udhëhiqet në punën e tij nga parimet e bamirësisë dhe parimet e drejtësisë.

### **Parimi i ruajtjes së integritetit profesional**

**Neni 8**

1. Anëtari është i detyruar të ruajë integritetin dhe dinjitetin profesional.
2. Anëtari është i detyruar të ruajë me të gjitha aftësitë e tij traditën fisnike të profesionit shëndetësor të profileve, duke ruajtur standarde të larta të punës profesionale dhe sjelljes etike ndaj pacientit dhe të afërmve të tij, si dhe ndaj shoqërisë dhe publikut në përgjithësi.

## **III. DETYRAT THEMELORE**

**Neni 9**

Anëtari me profesionin e tij shëndetësor i përkushtohet shëndetit publik dhe të përgjithshëm të njeriut, duke i'u përbajtur standardeve të shkencës mjekësore dhe parimeve etike.

### **Përgatitja profesionalë**

**Neni 10**

Anëtari duhet të jetë i vetëdijshëm për përgatitjen, kompetencat dhe kufizimet profesionale të tij, dhe të gjitha veprimet e tij duhet ti marrë komfor këtyre përgatitjeve dhe kompetencave

profesionale.

### **Edukimi i vazhdueshëm profesional**

#### **Neni 11**

1. Anëtari duhet të jetë i përkushtuar për zhvillimin dhe përparimin e profesionit dhe të kujdeset për edukimin e vazhdueshëm profesional.
2. Njohuritë e fituara profesionale duhet t'i përcjell te kolegët dhe profesionistët tjera shëndetësorë.

### **Zbatimi i protokolleve të shërbimit**

#### **Neni 12**

Anëtari gjatë ofrimit të shërbimeve shëndetësore brenda kompetencës profesionale ka për obligim të zbatoj protokollin përkatës të shërbimit i cili është në zbatim

### **Administrimi i terapisë**

#### **Neni 13**

1. Anëtari kryen administrim të barnave dhe terapisë tek pacienti, në parim, vetëm me përshkrimin mjekësore.
2. Anëtari është i detyruar ta informojë pacentin për pasojat për shëndetin e tij në rast të refuzimit të trajtimit me barnat e rekomanduara nga mjeku përgjegjës.

### **Ndihma urgjente**

#### **Neni 14**

1. Anëtari është i detyruar të ofrojë ndihmë mjekësore urgjente, në përputhje me kualifikimin e tij profesional
2. Puna në rast të rrethanave të jashtëzakonshme është një detyrim i veçantë për një anëtarë.
3. Anëtari duhet të njohë parimet moderne të doktrinës së punës në rrethana të jashtëzakonshme.

### **Situatat emergjente**

#### **Neni 15**

Anëtari në situata emergjente është i detyruar ti përgjigjet çdo ftese të autoriteteteve shtetërore për tejkalimin e situatës emergjente.

### **Respekti**

#### **Neni 16**

Anëtari duhet t'i respektojë të drejtat e pacientit, kolegëve dhe punëtorëve tjera shëndetësorë si dhe rregullat e institucioneve shëndetësore.

### **Sinjalizimi i kolegut**

#### **Neni 17**

1. Anëtari në çdo rast që vlerëson apo informohet se kolegu i tij abuzon me detyrat dhe përgjegjësitë e tij, duhet të sinjalizoj tek organet kompetente të Odës.
2. Oda siguron dhe mbanë përgjegjësinë për konfidencialitetin e sinjalizuesit.
3. Në rast të sinjalizimit të motivuar nga arsyet personale me tendencë abuzuese, denigruese për anëtarët tjerë të Odës, i njëjtë do të përgjigjet në bazë të rregullave dhe ligjeve në fuqi.

### **Transparenca e punës në poste publike dhe mos abuzimi**

#### **Neni 18**

1. Anëtarit në asnjë rast nuk i lejohet të abuzojë me privilegjet që i krijon statusi i tij profesional ndaj të sëmurit, kolegëve për qëllime përfitimi personal, material dhe jo material, apo çfarëdo forme tjeter të përfitimit.
2. Anëtari që kryen funksione administrative, apo i zgjedhur në poste publike, duhet të sigurojë transparencën më të lartë për gjithçka, që mund të duket si konflikt interesit në raport me shërbimin shëndetësor. Ai e ka të ndaluar të shfrytëzojë funksionin dhe postin e tij përfitime të tjera personale të kundërligjshme.
3. Anëtari, madje edhe jashtë ushtrimit të detyrës duhet shmangur çdo akt që do të zhvlerësonë personalitetin dhe dinjitetin e tij profesional.

### **Privatësia dhe konfidencialiteti - sekreti profesional**

#### **Neni 19**

1. Anëtari është i detyruar të mbajë fshehtësinë profesionale për pacientin dhe për anëtarët e familjes së pacientit, edhe pas vdekjes së tij.
2. Anëtari duhet të ruaj fshehtësinë profesionale për atë që ka rrëfyer pacienti edhe në rast kur fitohet në cilësinë e dëshmitarit nga autoritetet përkatëse, përveç nëse është e paraparë ndryshe me ligj.
3. I gjithë dokumentacioni mjekësor i pacientit është i natyrës konfidenciale dhe askush nuk ka të drejtë çasje në këto dokumente, përjashtimisht rasteve të parapara me ligj.

### **Privatësia në raport me subjektet**

#### **Neni 20**

1. Anëtari obligohet të ruajë të dhënat personale dhe shëndetësore të pacientit apo subjekteve tjera.
2. Ai është i detyruar të kujdeset që fshehtësia profesionale të ruhet edhe prej personave të tjerë që punojnë me të.

### **Qasja në dokumentacion mjekësor**

#### **Neni 21**

1. Anëtari i Odës duhet të mundësojë qasjen në dokumentacionin mjekësor nëse pacienti e kërkon këtë dhe me rregullin e brendshëm të institucionit nuk është caktuar përgjegjës tjetër.
2. Anëtari i Odës nuk duhet të përmendë emrin e pacientit në publik në mënyrë të tillë që të mos rrezikohet privatësia e pacientit.
3. Anëtari nuk mund të jap informata jashtë kompetencës profesionale.

**Zbulimi i fshehtësisë**  
**Neni 22**

Zbulimi i fshehtësive profesionale lejohet vetëm me pëlqimin e pacientit dhe nëse është në dobi të pacientit dhe familjes së tij ose interesit publik, si dhe nëse kërkonit nga organi kompetentë i njohur me ligj, në përputhje me procedurat ligjore

**Privatësia gjatë hulumtimeve**  
**Neni 23**

1. Të dhënat mbi rezultatet e hulumtimit mund të përdoren në studimet e kërkimit shkencor, por vetëm në një mënyrë qe siguron anonimitetin e pacientit dhe dinjitetin e pacientit.
2. Publikimi i te dhënave te pacientit me qëllim të hulumtimit shkencor dhe profesional është i mundur vetëm me pëlqimin e pacientit.

**IV.RAPORTET ME PACIENTIN**

**Mos shfrytëzimi emocional, fizik dhe material**  
**Neni 24**

Anëtari i Odës duhet ta kryej punën e tij në mënyrë profesionale dhe etike, pa e shfrytëzuar pacientin në aspektin emocional, fizik apo material.

**Parimi i ndershmërisë, besimit dhe respektit**  
**Neni 25**

1. Anëtari i Odës e bazon marrëdhënien e tij me pacientët dhe shoqërueshet e tyre mbi parimet e ndershmërisë, besimit dhe respektit.
2. Ata duhet të ruajnë gjithmonë dhe në çdo kohë kufijtë profesional në marrëdhëniet me pacientin. Anëtari duhet të sigurojë që të gjitha aspektet e marrëdhënies janë të lidhura vetëm në raporte profesionale me nevojat e pacientëve.
3. Sjellja korrekte brenda normave dhe rregullave të detyrës, komunikimi me qetësi, me siguri dhe brenda kompetencave të caktuara me pacientin dhe familjarët përbën një aspekt tjetër etik të anëtarëve. Shkelja apo tejkalim i këtyre normave është i dënueshëm

**Prania e familjarëve**  
**Neni 26**

Të afërmit e pacientëve apo persona të tjera mund të jenë të pranishëm gjatë dhënies së shërbimit nëse këtë e lejon pacienti, kushtet dhe mundësitë profesionale, nën kushtet e përcaktuara nga institucioni shëndetësor.

**Kolegialiteti dhe referimi**  
**Neni 27**

1. Anëtari komunikon me kolegët apo profesionistët tjera shëndetësor në rastet kur identifikon problem të mundshëm që do të cenonte trajtimin apo kujdesin e suksesshëm

shëndetësor të pacientit.

2. Ndalohet çdo implikim i anëtarit të Odës në referim të pacientëve.

### **Përshpejtimi i vdekjes dhe trajtimit**

#### **Neni 28**

1. Anëtarë është i detyruar të jetë i besueshëm dhe i sinqertë me pacientët e tij, duke parandaluar pritet joreale të pacientit pas përfundimit të trajtimit.
2. Anëtarë kujdeset për pacientin, cilado qofshin kushtet e tij klinike, edhe në fund të jetës, duke njojur rëndësinë e inkurajimit ambjental, fizik, ekologjik, shpirtëror.
3. Anëtarë nuk merr pjesë në trajtimet e fundit për shpejtimin e vdekjes të të asistuarit (pacientit) edhe në rastet kur kërkesa vjen nga i interesuari apo nga familjarët.
4. Anëtarë mbështet familjarët e pacientit në veçanti, në momentin e humbjes së jetës dhe më pas. Në mungesë të tyre, ata janë të detyruar të zhveshin, shtrijnë, rregullojnë fytyrën dhe shoqërojnë në trupin në morg.

### **Përfitimi financiar**

#### **Neni 29**

Përveç shpérblimit të rregullt për punën profesionale, në formën e pagës ose honorarit, një tjetër përfitim material ose ndonjë përfitim tjetër nga puna e tij mjekësore, si dhe kushtëzimi i ofrimit të një shërbimi shëndetësor me një dhuratë e definuar sipas legjislacionit në fuqi është në kundërshtim me këtë Kod, me përashtim të veprimitarive të akredituara të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional.

## **V. RAPORTET NDËRKOLEGIALE**

### **Solidariteti me kolegët**

#### **Neni 30**

1. Çdo anëtarë, e ka për detyrë të ruajë dhe respektojë solidaritetin me kolegët, në të mirë të ruajtjes së integritetit profesional dhe në respekt të normave të etikës, duke marrë parasysh edhe emaptinë e ndërsjelltë
2. Në rastet e konfliktit të shkaktuara nga ndryshimet e thella etike, anëtarë angazhohen për të gjetur zgjidhjen e duhur, përmes dialogut, vullnetit të mirë me parimet etike dhe me ndërgjegjen profesionale, e në rast nevoje edhe me ndërmjetësinë e autoriteteve institucionale apo organeve të Odës.
3. Anëtarit të Odës nuk i lejohet të diskutojë për lëshimet profesionale të kolegeve me pacientin, me familjarët, apo me kolegë dhe persona të tjera.

### **Mbrojtja e kolegëve**

#### **Neni 31**

1. Anëtarë i Odës do të mbrojë kolegët e vet, të cilët janë fajësuar në mënyrë të pabazë, sipas parimeve të kolegialitetit.
2. Nëse këto parregullsi nuk korrigohen, atëherë ai do t'u drejtohet organeve përkatëse në Odë.

3. Bashkëpunimi me anëtarë të profesioneve të tjera shëndetësore lejohet, nëse fushat e përgjegjësisë së anëtarit të Odës dhe anëtarit të profesionit tjetër shëndetësor mbahen qartë të ndara nga njëra-tjetra.

## **VI. RAPORTET E ANËTARËVE ME ODËN**

### **Obligimet e anëtarit**

#### **Neni 32**

1. Anëtari është i detyruar t'i përbushë obligimet që i ka ndaj Odës, të respektojë, të ruajë reputacionin, si dhe të kontribuojë në punën më të suksesshme të Odës.
2. Pakënaqësitë eventuale mbi punën apo vendimmarrjen e organeve të Odës dhe shërbimit profesional të Odës adresohen në organet kompetente brenda Odës.

### **Gjykimi disiplinor**

#### **Neni 33**

Pavarësisht institucionit publik apo privat në të cilin punon, si dhe pozicionit hierarkik në institucionin të cilit i përket, anëtari është i detyruar t'i përgjigjet çdo kërkese nga Oda, për tu paraqitur për një proces gjykimi disiplinor profesional, apo çfarëdo informacioni, a bashkëpunimi që i kërkohet nga Oda.

### **Efektet e vendimeve të Kuvendit**

#### **Neni 34**

1. Vendimet e Kuvendit të Odës janë obligative për të gjithë anëtarët e odës. Të njëjtat janë përfundimtare në procedurën e brendshme administrative dhe mund të atakohen vetëm në rrugë gjyqësore.
2. Anëtarët e organeve të Odës, të cilët gjatë ushtrimit të funksionit të tyre nuk veprojnë në përputhje me aktet normative materiale në fuqi, i nënshtronen përgjegjësisë disiplinore në organet etike të odës.

### **Obligimet e konfidencialitetit për anëtarët e organeve**

#### **Neni 35**

Anëtarët e organeve të Odës obligohen të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave në përputhje me rregulloren e veçantë të Këshillit Drejtues për konfidencialitetin.

## **VII. RAPORTET E INFERMIERËVE ME PUBLIKUN**

### **Raporti i anëtarit me publikun**

#### **Neni 36**

1. Anëtari i Odës si anëtarë i një profesioni të privilegjuar, fisnik dhe human , duhet të punoj dhe veprojë duke u kujdesur në atë mënyrë që të sigurojë besimin e pacientit dhe publikun për profesionin e infermierit dhe profileve tjera anëtare të Odës.
2. Anëtari nuk do të përdorë pozitën e tij profesionale me qëllim të shfrytëzimit të mungesës së njohurive të tjerëve,

3. Anëtari duhet të jetë i vetëdijshëm për natyrën sociale të profesionit të tij, prandaj masat shëndetësore duhet të mbështeten dhe promovohen për të përmirësuar shëndetin e përgjithshëm të popullatës
4. Anëtari ruan emrin dhe figurën morale, duke qëndruar larg veseve që i dëmtojnë si: alkooli, droga, imoraliteti. Rastet e shthurjes morale, paraqitjes në punë në gjendje të dehur apo nën efektin e substancave të jashtëligjshme, ndëshkohen.

### **Përdorimi i titujve profesional, shkencor apo akademik**

#### **Neni 37**

Anëtari nuk mund të përdorë një titull profesional, shkencor apo akademik, që nuk është fituar në përputhje me rregulloret përkatëse ligjore.

#### **Kodi i veshjes**

#### **Neni 38**

1. Profesionisti shëndetësorë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, duhet ti përbahet këtij kodi të veshjes:
  1. veshje të pastra, pa njolla, pa vrima ose grisje, të mbajtur në gjendje të mirë, dhe në përputhje me përmasat trupore;
  2. veshje që nuk kanë fotografi, mbishkrime, shkëlqim, xixa, dekoltetë e theksuara,
  3. bluzat me rripa, bluzat që zbulojnë barkun, funde që nuk kalojnë sipër gjurit
  4. funde pa hapje ose prerje, pantallonat e shkurtra me gjatësi nën gjunjë,
  5. veshje sportive, veshje me mesazh vulgariteti;
  6. veshjet duhet të mos janë transparente dhe të zbulojnë të brendshmet, rripat apo dantellat;
  7. ndalohen kapelat (përveç rasteve të veçanta që lidhen me aspektin shëndetësor),
  8. syzet e diellit, dhe aksesorë të ngjashëm në ambientet e punës;
  9. ndalohen kufjet gjatë komunikimit direkt me palët dhe stafin gjatë orarit të punës;
  10. ndalohen të gjitha llojet piercing në pjesët e dukshme të fytyrës dhe trupit, përveç vathëve të zakonshëm me madhësi normale;
  11. aksesorët të mos janë tepër të mëdhenj, me ngjyra ose forma të ekzagjeruara, apo me shenja diskriminuese;
  12. ndalohen sandalet, shapkët, dhe ecja zbathur në ambientet e punës;
  13. mustaqet, zylyfet, llojet e ndryshme të mjekrave, të janë të pastra dhe të prera mirë;
  14. grimi natyral;
  15. thonjtë të janë të pastër dhe me madhësi normale;
  16. Flokët veçanërisht në rastet kur janë të gjatë duhet të janë të lidhura për të shhangur çdo pengesë gjatë punës dhe për të ruajtur higjienën në mqediset e kujdesit shëndetësor. Flokët të janë të mirëmbajtur, dhe të mos janë të ngjyrosur me ngjyra ekstravagante;
  17. Çdo tatuazh ose shenjë e dukshme që mund të jetë irrituese për pacientët duhet të mbulohet për të ruajtur një pamje profesionale.
2. Shërbimet administrative të OIK të kërkuara nga ana e anëtarit me paraqitje në kundërshtim me dispozitat e këtij nenit, refuzohen deri në respektimin e këtij neni.

## **Përdorimi i uniformës shëndetësore**

### **Neni 39**

1. Dalja jashtë institucionit shëndetësorë me uniformën e punës për qëllime jo të lidhura me profesionin është e dënueshme.
2. Profesionistët e sallave të operacionit, reanimacionit dhe të gjithë kabinetave ku kërkohet sterilitet i veçantë duhet të përdorin uniforma përkatëse. Dalja jashtë ambientit të punës ul dinjitetin e tyre dhe rrit rreziqet për pacientin, dhe përbën një veprim të dënueshëm

## **VIII. REKLAMIMI I SHËRBIMEVE TË ANËTARËVE TË OIK**

### **Aktivitetet reklamuese dhe favorizuese**

#### **Neni 40**

Anëtar duhet ti shmanget çdo situate që bie ndesh me parandalimin e konfliktit të interesit gjatë ofrimit të shërbimeve shëndetësore. Është i ndaluar çdo aktivitet referues, reklamues apo favorizues që ndërlidhet me interesa të drejtpërdrejta materiale apo interesa tjera personale, duke përfshirë edhe produktet farmaceutike.

### **Fotografia e pacientit**

#### **Neni 41**

Përdorimi i fotografive të pacientit përmes internetit lejohet vetëm me pëlqimin me shkrim të pacientit dhe pa zbuluar identitetin e pacientit.

### **Promovimi i aktiviteteve të odës**

#### **Neni 42**

1. Promovimi i aktiviteteve të Odës bëhet vetëm nga personi i autorizuar, apo me lejen e personit të autorizuar nga Oda.
2. Anëtar i Odës kufizohet nga publikimet në rrjetet sociale të aktiviteteve që bien ndesh me kodin e etikës dhe me misionin e odës.
3. Anëtar i Odës, i cili në mënyrë direkte apo tërthorët lidhet me funksionin apo autoritetet e odës, kufizohet nga etiketimet dhe lincimet, përdorimin e fjalorit të pa përshtatshëm që i referohen personave fizik apo juridik dhe bartësve te institucioneve.

## **IX. IDENTIFIKIMI PROFESIONAL PERSONAL**

### **Identifikimi i anëtarëve**

#### **Neni 43**

Anëtar gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij profesionale, me qëllim të identifikimit dhe transparencës gjatë gjithë kohës mban kartën identifikuese të anëtarësisë së OIK apo të institucionit ku ushtron veprimtarinë profesionale shëndetësore

## **X. HULUMTIMET BIOMJEKËSORE**

### **Kërkesa për Hulumtim**

#### **Neni 44**

Anëtari, që merr përsipër një punë kërkimore, studiuse me qëllim hulumtues, parandalues, diagnostikues apo mjekues, ku përfshihen të sëmurë apo vullnetarë, detyrimisht paraqet projektin përpara një komisioni të posaçëm, kompetent e të pavarur, për të vlerësuar përgjigjen shkencore, pranueshmërinë etike dhe për ta miratuar.

### **Detyrime të përgjithshme për realizimin e hulumtimit**

#### **Neni 45**

1. Anëtari që ndërmerr hulumtime në fushën e biomjekësisë duhet të jetë i arsimuar dhe i trajnuar në pikëpamje shkencore.
2. Anëtari, që kërkon leje për hulumtime me qëllim të përgatitjes së punimeve akademike duhet të dëshmoj lejen e autoritetit ku zhvillohet studimi.
3. OIK para shqyrtimit dhe miratimit të kërkesës do të siguroj lejet dhe konfirmimet e nevojshme nga institucionet relevante, shkencore, klinike dhe profesionale, në veçanti QKUK.
4. Në hulumtimet biomjekësore, anëtari duhet t'i përbahet parimeve etike që rrjedhin nga Deklarata e Helsinkit dhe rishikimeve të saj; Praktika e Mirë Klinike; legjislacioni në fuqi, si dhe në përputhje me protokollet e miratuara nga organi kompetent
5. Anëtari që kryen hulumtimin është i detyruar t'i njoftojë personat që janë përfshirë në projektin hulumtues në detaje për qëllimin e punës, përfitimet e pritshme dhe rreziqet e mundshme, dhe të marrë pëlqimin e tyre me shkrim. Nëse kjo nuk është e mundur për shkak të moshës së mitur, paaftësisë ose gjendja e vetëdijes së personit, kërkohet pëlqimi nga përfaqësuesi ose kujdestari i tij / saj ligjor, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
6. Për kërkosat për hulumtime shkencore të natyrës klinike dhe mjekësore, OIK do të angazhoj ekipe të ekspertëve të cilët vlerësojnë implikimet e mundshme negative te komuniteti i cili është objekt studimi dhe hulumtimi.
7. Përshtatja, kryerja dhe nxitja e metodave të pavërtetuara shkencërisht që ngjallin shpresë të rrejshme te pacientët dhe familjarët e tyre, është i ndaluar dhe përbëjnë shkelje të rëndë të Kodit etik dhe deontologjisë të infermierëve.

### **XI. KATEGORIZIMI I SHKELJEVE**

#### **Klasifikimi i shkeljeve**

#### **Neni 46**

1. Shkeljet e dispozitave të këtij kodi mund të klasifikohen:
  - a. Shkelje të Lehta dhe
  - b. Shkelje të Rënda.

#### **Kriteret e klasifikimit**

#### **Neni 47**

1. Klasifikimi i shkeljes në të lehtë apo të rëndë bëhet nga Këshilli Etik. Me rastin e klasifikimit të shkeljes, Këshilli Etik vendos me të paktën 4 vota.
2. Me rastin e klasifikimit Këshilli Etik merr për bazë:
  1. Shkallën e përgjegjësisë etike
  2. Motivet e shkeljes
  3. Dëmtimin e vlerës së mbrojtur

4. Rrethanat në të cilën është bërë shkelja
5. Sjelljen e mëparshme të shkelësit
6. Pranimin e fajit
7. Zotimi se i njëjti nuk do të përsërit shkeljen e njëjtë.

### **Shkeljet e rënda**

**Neni 48**

Rastet e veprimit në kundërshtim me nenet 13, 14, 15, 16, 19, 20, 24, 27, 28, 30, 34, 35, 37, 41, 44, 45 si dhe përsëritja e shkeljes së lehtë brenda periudhës 12 mujore nga masa e shqiptuar, klasifikohen si shkelje të rënda dhe nuk mund të ndryshohen nga Këshilli Etik pavarësisht nga neni paraprak.

### **Tërheqja e përkohshme e licencës**

**Neni 49**

1. Në rastet e shkeljeve të rënda sipas këtij kodit, Prokurori i Odës me rastin e fillimit të hetimeve mund ti propozon Këshillit Etik tërheqjen e përkohshëm të licencës së anëtarit për periudhë jo më gjatë se 6 muaj.
2. Këshilli Etik vendos mbi kërkesën e këtij propozimi brenda 15 ditëve nga propozimi i Prokurorit të Odës.

### **Masat disiplinore**

**Neni 50**

1. Këshilli Etik për shkeljet e lehta të Kodit Etik mund të shqiptoj këto masa:
  - a. Rekomandim kolegial
  - b. Kërkim falje ndaj pacientit
  - c. Qortim ose qortim publik
    - Qortimi publik mund të ketë efekt jo më shumë se 1 vit nga plotfuqishmëria e tij
2. Nëse shkelësi nga paragrafi 1 nuk i bindet dhe nuk vepron përball masave, si dhe ne shkeljet e rënda Këshilli Etik mund të shqiptojë masat disiplinore tjera të paraparë nga Ligji për Odat e profesionistëve shëndetësorë si:
  - a. Arsimim shtesë dhe të detyrueshëm pasuniversitar dhe trajnim;
  - b. Trajtim i detyrueshëm nga alkooli, droga dhe veset tjera;
  - c. Tërheqja e përkohshme në afat deri një (1) vjeçar;
  - d. Tërheqja e përhershme e licencës dhe/ose fshirja e profesionistit shëndetësor nga regjistri, e shoqëruar me vendim të gjykatës që ndërlidhen me ushtrimin e profesionit;
  - e. Dënim me të holla njëmijë (1000) deri në tremijë (3000) Euro për çdo shkelje të ligjit, detyrave profesionale dhe etike.
- 2.1. Për shqiptimin e masave nga paragrafi 2, pika a dhe b Këshilli Etik paraprakisht siguron ekspertizë profesionale, dhe në vartësi të ekspertizës përcakton kohëzgjatjen e masës.
3. Shqiptimi i masave duhet të regjistrohen në sistemin elektronik të odës.

## XII. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

### Neni 51

1. Çdo sjellje joprofesionale në kundërshtim me dispozitat e këtij Kodi, përbën objekt për ndjekje dhe gjykim disiplinor profesional bazuar në Ligjin për Odat e Profesionistëve Shëndetësor Nr.04/L-150, Statutin e Odës, Kodin Etik dhe aktet e brendshme normative.
2. Oda është e detyruar të harmonizojë aktet e përgjithshme me dispozitat e këtij Kodi brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e këtij Kodi.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij Kodi, shfuqizohet kodi i miratuar në Kuvend me datë 12.06.2015 dhe çdo dispozitë nën status që është në kundërshtim me këtë kod.
4. Ky Kod hyn në fuqi tetë ditë pas miratimi të tij në Kuvendin e Odës.

Kryetare e OIK  
Nexhmije Gori



Prishtinë, 2025

## **SHTOJCA 1**

### **DEKLARATË NËN BETIM ME RASTIN E ANËTARËSIMIT**

Përmes kësaj deklarate, unë i/e nënshkruar/i/a më poshtë, duke qenë i vetëdijshëm mbi përbajtjen dhe kërkesat etike të parapara me Kodin e Etikës dhe Deontologjisë së Odës së Infermierëve, mameve dhe profesionistëve shëndetësor, konfirmoj që gjatë ushtrimit të veprimitarisë time nuk kam shkelje etike të shqiptuara nga organet kompetente si dhe kam njohuri të plotë mbi kërkesat etike të tanishme për ushtrim të profesionit.

I/E vetëdijshëm/me që deklarata e rreme sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, paraqet vepër penale, deklaroj me përgjegjësi të plotë morale dhe ligjore se të dhënrat e paraqitura në këtë deklaratë janë të vërteta dhe të sakta, si dhe se në rastin e kundërt i marrë përsipër të gjitha pasojat e parapara me legjislacionin në fuqi.

Me anë të kësaj deklarate autorizoj Odën e Infermierëve të Kosovës që në çdo kohë të mund të bëjë verifikimin e këtyre të dhënavë të paraqitura në deklaratë, kurse konfirmimin eventual mund ta bëjë përmes kontaktave të paraqitura me rastin e deklarimit tim.

Emri dhe Mbiemri: \_\_\_\_\_

Institucioni/Punëdhënës (nëse është i/e punësuar): \_\_\_\_\_

Nr. personal i letërnjoftimit: \_\_\_\_\_

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_

Datë: \_\_\_\_\_